



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E PËRGJITHSHME
PROKURORIA E PËRGJITHSHME

**SHPALLJE PËR LËVIZJE PARALELE
DHE PËR PRANIMIN NË SHËRBIMIN CIVIL
NË KATEGORINË EKZEKUTIVE (Specialist)**

Njoftim për vënd pune të lirë në administratë në pozicionin “specialist”, në Prokurorinë e Përgjithshme.

Në mbështetje të Ligjit nr.152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar, Kreut IV, “Pranimi në shërbimin civil”, neni 23, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.243, datë 18.03.2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, Prokuroria e Përgjithshme, shpall konkurrimin për nëpunës civil të kategorisë ekzekutive III-b, pika 2, klasa B, për vëndin e punës në pozicionin “**specialist – juristë**”. Proçedura e rekrutimit, përzgjedhjes dhe periudha e provës do të realizohet:

Pozicionet më sipër, u ofrohen fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele!

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

- a- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar, brenda së njëjtës kategori;
- b- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- c- Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mirë”;

Vetëm në rast se nga ky pozicion, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ende ka pozicion vakant, ai është i vlefshme për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimi në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive.

Data e dorëzimit të dokumentave: 25.03.2023

***Afati i aplikimit dhe dorëzimit të dokumentacionit është i njëjtë për të dyja procedurat.**

A) Konkurrimi për vëndin e punës në pozicionin “specialist-juristi”, pranë Prokurorisë së Përgjithshme Tiranë, do të bazohet në:

- Njohuritë për Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;
- Ligjin nr.97/2016, “Per organizimin e funksionimin e Prokurorisë së Përgjithshme;
- Ligji nr.98/2016 për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë’,
- Ligji25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore “

- *Kodin e Proçedurave Administrative;*
- *Kodi i Procedures Penale.*
- *Rregulloren e Brendshme te Prokurorisë së Përgjithshme;*

B) Konkurrimi do te zhvillohet ne dy faza:

I. Faza e parë:

- Verifikimi paraprak i kandidatëve per plotësimin e kërkesave të përgjithshme dhe atyre te veçanta të përcaktuara në shpalljen për konkurim
- Sektori i Burimeve Njerëzore në bazë të dokumentacionit të paraqitur, jo më vonë se 5 (pesë) ditë pune nga data e mbylljes se pranimit të tyre, do të bëjë verifikimin paraprak të kandidatëve, që përmbushin kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta, të përcaktuara në shpalljen për konkurim
- Kandidatet që plotësojnë kërkesat e përgjithshme dhe të vecanta të pozicionit të punës, renditen në një listë sipas rendit alfabetik e cila administrohet në S.B.Nj dhe do të shpallet në faqen zyrtare të internetit PP dhe në hyrjen kryesore te Prokurorisë së Përgjithshme.
- Kandidatet, që nuk plotësojnë kërkesat e përcaktuara në shpalljen për konkurim, renditen në një listë të veçantë në të cilën regjistrohen edhe arsyet e mosplotësimit të këtyre kërkesave. Kjo listë nuk publikohet dhe administrohet në S.B.Nj e cila njofton në mënyrë individuale kandidatët që nuk janë kualifikuar.
- Çdo kandidat ka të drejtë të paraqesë ankesë pranë S.B.Nj, brenda 5 (pesë) ditëve kalenderike nga data e shpalljes së listës. Ankuesi merr përgjigje brënda 5 (pesë) ditëve kalenderike nga data e depozitimit të ankesës

II. Faza e dytë përbëhet nga vlerësimi i kandidatëve që perfshin:

- Vlerësimin e jetëshkrimit të kandidatëve, që konsiston në vlerësimin e arsimit, të eksperiencës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, si dhe vlerësimet e arritjeve vjetore
- Vlerësimi me shkrim.
- Intervista e strukturuar me gojë.

C) Pranimi do të bëhet për 1 (një) vend pune në pozicionin “specialist- jurist”.

Ç) Për pranimin në shërbimin civil, kandidati duhet të plotësojë *kërkesat e përgjithshme* sipas nenit 21, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si më poshtë:

- Të jetë shtetas shqiptar.
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar.
- Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur.
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse.

- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje.
- Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas këti ligji.

D) Kërkesat e veçanta që janë prioritet në përzgjedhjen e kandidatëve:

- Të ketë përfunduar arsimin e lartë dhe të jetë diplomuar për Drejtësi.
- Të ketë përvojë pune jo më pak se **10 vjet**, prioritet përbën që përvoja punës të ketë lidhje me organet e drejtësisë dhe hetimin.
- Zotërimi i një gjuhe të huaj të BE-së është prioritet.
- Të jetë pajisur me certifikat sigurie.
- Të ketë aftësi të mira komunikimi dhe të punës në grup.

G) Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit

Të gjithë kandidatët si më sipër duhet të dorëzojnë dokumentacionin si më poshtë:

- Jetëshkrimin;
 - Fotokopje të diplomës;
 - Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë përvojën në punë);
 - Çdo dokumentacion që vërteton eksperiencën të tjera punësimi brenda ose jashtë vendit, të lëshuar nga punëdhënësi;
 - Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.
- Kandidatët nga jashtë shërbimit civil, përveç sa më sipër duhet të dorëzojnë dokumentacionin si vijon:
- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
 - Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
 - Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;

Mënyra e dorëzimit me postë ose e drejtpërdrejtë në protokollin e institucionit me adresë: Prokuroria e Përgjithshme/Spektori i Burimeve Njerëzore (konkurrimi për vendin e punës në pozicionin “specialist – auditues i brendshëm”) me adresë: Rruga “Qemal Stafa, nr.1, Tiranë.

F) Mënyra e vlerësimit të kandidatëve:

- Vlerësimi i jetëshkrimit të kandidatëve, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të eksperiencës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, si dhe vlerësimet e arritjeve vjetore;
- Vlerësimi me shkrim;
- Intervista e strukturuar me gojë.
- Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është 100, të cilat ndahen përkatësisht:
- Për vlerësimin e jetëshkrimit (cv) të kandidatëve, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të

eksperiencës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, si dhe vlerësimet e arritjeve vjetore, 20 pikë;

- Për vlerësimin me shkrim, 40 pikë.

- Për intervistën e strukturuar me gojë, 40 pikë;

i) Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët do të bëhet nëpërmjet adresave të email-, me mesazhe në numrin e celularit të kandidatit, në faqen e internetit të Prokurorisë së Përgjithshme.

Për me shume informacion për Prokurorinë e Përgjithshme dhe veprimtarinë e saj mund te vizitoni edhe faqen tonë në internet: www.pp.gov.al.

PROKURORIA E PËRGJITHSHME

TIRANË MË 01.03.2023